

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Aquilum Wave Technologies” shpk**

Sot, në datë 10.09.2024, unë themeluesja, Joana Nuhaj, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J45402127G, i datëlindjes 02.04.1994, lindur në Lushnje dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1:  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Aquilum Wave Technologies” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e fushën e teknologjise se informacionit, Sherbime te menaxhimit te Teknologjive kompjuterike. Disenjimi i infrastruktures se Teknologjive kompjuterike Sherbime te mbrojtjes kompjuterike, mbrojtje ndaj cyber security, back up, mbrojtje end point, mbrojtje te te dhenave, konsulencë dhe ndihmë për çështjet e menaxhimit të projektit në lidhje me riorganizimin dhe kompjuterizimin e proceseve të biznesit. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, Testim software, Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Don Bosko, rruga Albanopoli, pallati Alpha Nr 59, Ap39, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5:  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 12,000 (Dymbëdhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Joana Nuhaj.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)



**Neni 6:  
Administratori**

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Joana Nuhaj, shtetas shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal J45402127G i datëlindjes 02.04.1994, lindur në Lushnje dhe banuese në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.


**Neni 7:  
Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8:  
Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAK I VETËM  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Aquilum Wave Technologies" shpk**

  
Joana Nuhaj  
(Emër, Mbiemër, Firma)